



Z. Bujar Leskaj
Kryetar
Kontrolli i Lartë i Shtetit

Nr. 43 Prot.
Tiranë, më 24/04/2020

I nderuar z. Kryetar,

Fillimisht më lejoni që në emër të Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe Opozitës së Bashkuar t'Ju shpreh vlerësimin tonë maksimal për punën tuaj dhe të institucionit që drejtoni në funksion të garantimit të përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore.

Partia Demokratike dhe Opozita e Bashkuar po ndjek nga afër situatën e krijuar nga COVID-19 dhe menaxhimin e saj nga autoritetet shtetërore. Me shumë shqetësim kemi konstatuar se gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa procedura prokurimi, të cilat janë jo vetëm jo transparente, por krijojnë bindjen e thellë, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se janë korruptive dhe abuzive.

Konkretisht, bëhet fjalë për këto procedura prokurimi:

1. **Ministria e Mbrojtjes:** Loti I "Blerje paketa ndihme per familjet ne nevoje per perballimin e emergjences se shkaktuar nga renia e pandemise se virusit COVID - 19, per nevoja te Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave Materiale te Shtetit".
2. **Ministria e Mbrojtjes:** Loti II "Blerje materiale mbrojtese per mbeshtetjen e personelit te Forcave te Armatosura te angazhuar ne perballimin e emergjences se shkaktuar nga renia e pandemise se virusit COVID - 19, per nevoja te SHPFA".
3. **Ministria e Drejtësisë:** "Blerje materiale mjekesore ne kuader te masave per parandalimin e perhapjes se virusit COVID-19", fituar nga shoqeria FEDOS shpk.
4. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje materiale per mbrojtjen personale (MMP) per COVID-19", fituar nga bashkimi i shoqerive FARMA NET ALBANIA shpk, dhe shoqeria EUROMED shpk.

Adresa: Selia Qendrore "Partia Demokratike e Shqipërisë", Bulevardi Zhan Dark , nr 11,Tiranë

5. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje kite per laboratorin mikrobiologjik per realizimin e RT-PCR te pershtatshem per t'u perdorur per pajisjen e Existation te firmes Bioneer ose ekuivalent" per QSUT-ne", fituar nga shoqeria O.E.S DISTRIMED shpk.
6. **Ministria e Shëndetësisë:** "Trajtim dhe asgjesim te mbetjeve qe dalin nga sherbimet ku marrin trajtim pacientet me COVID-19 per QSUT", fituar nga shoqeria ECO RICIKLIM shpk.
7. **Ministria e Shëndetësisë:** "Per miratimin e kontrates me objekt "Furnizim vendosje respiratore me dy modalitete per adulte dhe moshe pediatrike per COVID-19", fituar nga shoqeria TBS 96 shpk.
8. **Ministria e Shëndetësisë:** "Furnizim me produkte letre njëpërdorimshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjienike, për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor", fituar nga EUROMEGA 2010 shpk.
9. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 të Snibe Co.ltd ose Ekuivalent", fituar nga GENIUS shpk.
10. **Ministria e Shëndetësisë:** "Spostimi i sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve tek godina e spitalit infektiv (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)", fituar nga TEOREN shpk.
11. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP", fituar nga BIOMETRIC ALBANIA shpk.
12. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje materiale konsumi laboratorike për ISHP", fituar nga KRIJON shpk.
13. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje barna Ribavirin 200 mg tabletë/kapsulë", fituar nga REJSI FARMA shpk.
14. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje barna Oseltamivir (Tamiflu) 75 mg/tabletë", REJSI FARMA shpk.
15. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerja barna Omeprazol 40 mg/vial flakon", fituar nga MEGAPHARMA shpk.
16. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje barna Propofol 10 mg/ml – 50 ml Flakon", REJSI FARMA shpk.
17. **Ministria e Shëndetësisë:** "Blerje barna Beclomethasone + Salbutamol 80 mcg+1600 mcg flakon", fituar nga MEDICAMENTA shpk.

Të gjitha këto procedura, për aq sa janë bërë publike, provojnë paracaktimin e fituesve dhe një rritje fiktive të çmimeve të blerjes së mallrave të prokuruar. Pjesa dërrmuese e kontratave është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe nuk është bërë as publikimi i ofertave dhe as publikimi i kontratës. Nga ana tjetër, pjesa dërrmuese e procedurave janë klasifikuar në kundërshtim flagrant të ligjit si procedura që realizohen në kuadër të përjashtimit të parashikuar në

nenin 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar", duke eleminuar cdo minimum transparence mbi to.

Në këtë kuadër, nisur nga interesi i lartë publik dhe nevoja për të garantuar mirëpërdorimin e fondeve publike, kërkojmë bashkëpunimin institucional të Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin në një kohë sa më të shpejtë të mundshme të këtyre procedurave të prokurorit, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë, si dhe ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit të fondeve publike të shpenzuara.

Me bindjen se Kontrolli i Lartë i Shtetit do të vazhdojë të japë kontributin e tij për garantimin e mirëadministrimit të fondeve publike, me lejon të shpreh konsideratën time më të lartë për punën tuaj.

Me respekt,

Gazment BARDHI



Sekretar i Përgjithshëm
Partia Demokratike e Shqipërisë